

Gjykata Evropiane
e të Drejtave të Njeriut

Pyetje
dhe
Përgjigje



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



Pyetje
dhe
Përgjigje

Këto pyetje dhe përgjigje janë përgatitur nga Sekretariati i Gjykatës.

Dokumenti nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

Ai ka për qëllim të japë informacion të përgjithshëm bazë për mënyrën se si funksionon Gjykata. Për informacion më të hollësishëm, lexoni dokumentet e nxjerra nga Sekretariati (të cilat gjenden në faqen zyrtare të Gjykatës, www.echr.coe.int) dhe në veçanti Rregulloren e Gjykatës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
Council of Europe
67075 Strasbourg cedex
France
www.echr.coe.int

Çfarë është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë ndërkombëtare me qendër në Strasburg. Ajo përbëhet nga një numër gjyqtarësh, i njëjtë me numrin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që e kanë ratifikuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut – aktualisht ka dyzet e gjashtë gjyqtarë¹ gjyqtarë. Gjyqtarët gjykojnë në cilësi individuale dhe nuk përfaqësojnë asnjë shtet. Për shqyrtimin e kërkesave, Gjykata ndihmohet nga Sekretariati i përbërë kryesisht nga juristë të të gjitha shteteve anëtare (të cilët njihen si referentë). Juristët janë krejtësisht të pavarur nga shteti nga i cili vijnë dhe nuk përfaqësojnë as kërkuuesit, as shtetet përkatëse.

Çfarë është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një traktat ndërkombëtar që mund të nënshkruhet vetëm nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa, e cila themelon Gjykatën dhe përcakton funksionimin e saj, përmban një listë të atyre të drejtave dhe garancive që shtetet kanë rënë dakord të respektojnë.

¹ Disa prej shteteve anëtare nuk kanë ratifikuar të gjitha Protokollet e Konventës (instrumente që krijojnë të drejta shtesë). Informacion të mëtejshëm në lidhje me këtë çështje mund të gjeni në faqen tonë zyrtare të internetit.

Çfarë bën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

Gjykata zbaton Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Misioni i saj është të marrë masa që shtetet të respektojnë të drejtat dhe garancitë e përcaktuara në Konventë. Për këtë, Gjykata shqyrton ankesat (të cilat njihen si "kërkesa") e bëra nga individë ose, ndonjëherë, nga vetë shtetet. Gjykata merr një vendim pasi konstaton se një shtet anëtar ka shkelur një apo më shumë nga këto të drejta dhe garanci. Vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme, që do të thotë se shtetet e përfshira në gjykim janë të detyruara t'i zbatojnë ato.

Kur mund t'i drejtohem Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut?

Ju mund të paraqisni një kërkesë në Gjykatë, në rast se mendoni se keni qenë personalisht dhe drejtpërdrejt viktimë e një shkeljeje të të drejtave dhe garancive të përcaktuara në Konventë ose në Protokollet e saj. Shkelja duhet të jetë kryer nga njëri prej shteteve që janë të detyruara të zbatojnë Konventën.

Çfarë të drejtash mbrohen nga Konventa dhe Protokollet e saj?

Konventa mbron në veçanti këto të drejta:

- ☞ të drejtën për jetën;
- ☞ të drejtën për proces të rregullt gjyqësor në çështje civile dhe penale;

- ☞ të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare;
- ☞ lirinë e shprehjes;
- ☞ lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;
- ☞ të drejtën për një rekurs efektive;
- ☞ të drejtën për gëzim paqësor të pronës; dhe
- ☞ të drejtën për të votuar dhe për t'u votuar.

Çfarë ndalon Konventa dhe Protokollet e saj?

Në veçanti ndalon:

- ☞ torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruës;
- ☞ ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm;
- ☞ diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë;
- ☞ dëbimin nga një shtet i shtetasve të vet ose moslejimin e hyrjes së tyre në territorin e vendit;
- ☞ dënimin me vdekje; dhe
- ☞ dëbimin kolektiv të të huajve.

Çfarë kushtesh duhet të plotësohen për të bërë një kërkesë në Gjykatë?

Cilat janë kushtet që duhen plotësuar?

- ☞ Nuk është e nevojshme të jeni shtetas i njërit prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Mjafton që shkelja për të cilën ankoheni të jetë kryer nga njëri prej këtyre Shteteve, brenda juridiksionit të tij, që zakonisht përkon me territorin e atij vendi.

- ☞ Mund të jeni individ privat ose subjekt juridik, si kompani, shoqatë, etj.
- ☞ Duhet të keni qenë drejtpërdrejt dhe personalisht viktimë e shkeljes që pretendoni. Nuk mund të ankoheni për një ligj apo për një akt në përgjithësi, sepse ju duket i padrejtë. Nuk mund të ankoheni as në emër të personave të tjerë (kjo mund të bëhet vetëm në rast se ato identifikohen qartë dhe nëse ju jeni përfaqësuesi i tyre zyrtar).

A ka ndonjë procedurë që duhet të ndiqet paraprakisht në gjykatat vendase?

- ☞ Po. Ju duhet të keni shteruar në shtetin e paditur të gjitha mjetet e mundshme ligjore që do të kishin bërë të mundur zgjidhjen e situatës për të cilën ankoheni (kjo do të thotë që ju jeni ankuar në gjykatën kompetente dhe, nëse është e nevojshme, madje edhe në një shkallë më të lartë, si Gjykata e Lartë ose Gjykata Kushtetuese, nëse ka të tillë në vend).
- ☞ Vetëm përdorimi i këtyre mjeteve ligjore nuk mjafton. Gjatë shterimit të shkallëve të ndryshme ligjore, ju duhet të keni nxjerrë në pah edhe ankesat tuaja (domethënë, përmbajtjen e shkeljeve të Konventës që ju pretendoni se janë bërë ndaj jush).
- ☞ Për të sjellë kërkesën në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ju keni vetëm katër muaj kohë nga data e vendimit të formës së prerë marrë në nivel vendor (në përgjithësi, ky është vendimi i gjykatës më të lartë në vend). Kërkesa juaj nuk mund të pranohet nga Gjykata, në rast se kanë kaluar më shumë se katër muaj nga vendimi i formës së prerë.

Kundër kujt mund të bëhet një kërkesë?

- ☞ Kundër një ose më shumë shteteve që janë të detyruar ta zbatojnë Konventën, në rast se ju mendoni se (nëpërmjet veprimit ose mosveprimit që ju prekin në mënyrë të drejtpërdrejt) ky shtet apo këto shtete kanë shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- ☞ Veprimi ose mosveprimi për të cilin ankoheni duhet të jetë kryer nga një ose më shumë autoritete publike në shtetin/shtetet në fjalë (për shembull, nga një gjykatë ose nga një autoritet administrativ).
- ☞ Gjykata nuk mund të merret me ankesat kundër individëve ose institucioneve private, si për shembull kundër kompanive tregtare.

Për çfarë mund të bëhet një kërkesë?

- ☞ Kërkesa duhet të ketë të bëjë me një nga të drejtat e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shkeljet e pretenduara mund të mbulojnë një larmi çështjesh, si torturën dhe keqtrajtimin e të burgosurve, ligjshmërinë e ndalimit, të metat e një procesi civil ose penal, diskriminimin në ushtrimin e një të drejte të Konventës, të drejtat e prindërve, respektimin e jetës private, të jetës familjare, të vendbanimit dhe letër-këmbimit, kufizimet në shprehjen e mendimit ose në dhënien a marrjen e informacionit, lirinë për të marrë pjesë në një tubim ose demonstratë, dëbimin dhe ekstradimin, konfiskimin e pasurisë dhe shpronësimin.
- ☞ Ju mund të ankoheni vetëm për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nuk mund të ankoheni për shkelje të ndonjë instrumenti tjetër ligjor, si për shembull, për shkelje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut apo të Kartës së të Drejtave Themelore.

Si mund t'i drejtohem Gjykatës nëse mendoj se jam viktimë e shkeljes së Konventës?

Duke dërguar në Gjykatë një formular² ankimi të plotësuar dhe të firmosur. Formulari i ankimit së bashku me dokumentet mbështetëse, duhet të dërgohen me postë në adresën e mëposhtme:

**The Registrar
European Court of Human Rights
Council of Europe
67075 Strasbourg cedex
France**

- ☞ Letra mund të shkruhet në njërin nga gjuhët zyrtare të Gjykatës (anglisht dhe frëngjisht), ose në gjuhën zyrtare të njërit prej shteteve që e kanë ratifikuar Konventën.
- ☞ Nuk është e nevojshme që ju të dërgoni formularin e ankimit me faks, pasi kjo gjë nuk do të ndërpresë ecjen e afatit të parashikuar në Konventë për paraqitjen e një ankimi në Gjykatë. Vetëm kopja origjinale e formularit të ankimit e dërguar me postë do të konsiderohet prej Gjykatës.
- ☞ Nuk është e nevojshme që ju të vini personalisht në Strasburg për të paraqitur çështjen tuaj. Ardhja juaj në Gjykatë nuk e përshpejton shqyrtimin e çështjes suaj dhe asnjë këshillë ligjore nuk do t'ju jepet nga ana e Sekretariatit.
- ☞ Sekretariati mund t'ju kërkojë dokumente, informacione ose shpjegime shtesë lidhur me ankesën tuaj.

² Formulari mund të gjendet në adresën tonë zyrtare në internet.

- ☞ Ju duhet të shkarkoni formularin e ankimit nga faqja e internetit të Gjykatës, t'a plotësoni atë me kujdes dhe në mënyrë të lexueshme, t'a firmosni dhe t'ia ktheni Gjykatës sa më shpejt që të jetë e mundur. Ankesa juaj duhet të përmbajë:
 - një përmbledhje të shkurtër të fakteve dhe ankesave tuaja,
 - të drejtat e Konventës, që mendoni se ju janë shkelur,
 - mjetet e ankimit që keni përdorur,
 - kopje të vendimeve të marra për çështjen tuaj nga autoritetet publike vendase (këto dokumente nuk do t'ju kthehen, prandaj duhet të dërgoni vetëm kopje të tyre) dhe
 - nënshkrimin tuaj si kërkues ose nënshkrimin e përfaqësuesit tuaj.
- ☞ Nëse nuk dëshironi që identiteti juaj të bëhet i ditur, duhet të informoni menjëherë Gjykatën duke parashtruar në mbështetje arsytet përkatëse. Kërkesa juaj do të shqyrtohet më pas nga Kryetari i Gjykatës.
- ☞ Në këtë fazë të procesit gjyqësor ju nuk jeni të detyruar të përfaqësoheni nga një avokat. Megjithatë, nëse dëshironi, ju duhet të plotësoni dhe të firmosni pjesën e duhur të formularit të ankimit.

Cilat janë karakteristikat kryesore të procedurës në Gjykatë?

- ☞ Procedura zhvillohet me shkrim. Ju do të informoheni me shkrim për çdo vendim që do të marret nga ana e Gjykatës. Seancat publike organizohen në raste përjashtimore.
- ☞ Çështja juaj do të trajtohet falas.
- ☞ Megjithëse në fazat e para të procesit gjyqësor nuk është e nevojshme të përfaqësoheni nga një avokat, ju do të keni nevojë për të në momentin që kërkesa juaj do t'i komunikohet qeverisë. Megjithatë, shumica dërrmuese e kërkesave shpallen të papranueshme pa qenë e nevojshme që t'i komunikohen qeverisë.

- ☞ Shpenzimet tuaja (si për shembull, pagesa e avokatit ose shpenzimet lidhur me punën kërkimore dhe letër-këmbimin) do t'ju duhet t'i përballoni vetë.
- ☞ Pasi të keni depozituar kërkesën, ju mund të kërkoni edhe ndihmë ligjore. Ndihma ligjore nuk jepet automatikisht, as menjëherë, por vetëm në një fazë të mëvonshme të procedurës.

Cilat janë fazat kryesore të procedurës?

- ☞ Si fillim, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse kërkesa juaj është e pranueshme. Kjo do të thotë që çështja duhet të plotësojë disa kushte të përcaktuara në Konventë. Kërkesa juaj nuk do të pranohet, në rast se këto kushte nuk plotësohen. Nëse keni bërë disa ankesa, Gjykata mund të shpallë të pranueshme një ose disa prej tyre dhe të rrëzojë të tjerat.
- ☞ Në rast se kërkesa juaj ose njëra prej ankesave tuaja shpallet e papranueshme, ky vendim është i formës së prerë dhe i pakthyeshëm.
- ☞ Në qoftë se kërkesa juaj ose njëra prej ankesave tuaja shpallet e pranueshme, Gjykata fton palët (ju dhe shtetin në fjalë) të arrijnë një zgjidhje miqësore. Nëse kjo zgjidhje nuk arrihet, Gjykata shqyrton themelin e çështjes – domethënë, gjykon nëse ka pasur shkelje të Konventësapo jo.

Sa kohë zgjat procedura para Gjykatës?

- ☞ Nisur nga ngarkesa e punës, mund t'ju duhet të prisni një vit para se Gjykata të mund të procedojë me shqyrtimin fillestar të kërkesës tuaj. Disa kërkesa mund të trajtohen si urgjente dhe me përparësi, veçanërisht kur thuhet se integriteti fizik i kërkuesiti është në rrezik fizik të menjëhershëm.

Çfarë mund të shpresohet të arrihet?

Në rast se Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur shkelje, ajo mund të vendosë t'ju jepet një shpërblim i drejtë, që përbën një kompensim financiar për dëmin që keni pësuar. Gjithashtu, Gjykata mund t'i kërkojë shtetit përkatës t'ju rimbursojë shpenzimet që keni bërë për të paraqitur çështjen tuaj në Gjykatë. Në rast se Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje, ju nuk do të duhet të paguani shpenzime të tjera (për shembull shpenzimet e kryera nga Shteti i paditur).

Lutemi vini re:

- ☞ Gjykata nuk ka të drejtë të rrëzojë vendimet ose ligjet vendase.
- ☞ Gjykata nuk është përgjegjëse për zbatimin e vendimeve të saj. Pasi ka dhënë vendimin, përgjegjësia i kalon Komitetit të Ministrave³ të Këshillit të Evropës, i cili ka për detyrë të mbikqyrë ekzekutimin dhe të marrë masat që kompensimi të paguhet.

³ Komiteti i Ministrave përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve anëtare ose përfaqësuesit e tyre.

Çfarë nuk mund të bëjë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

- ☞ Gjykata nuk vepron si gjykatë apeli kundrejt gjykatave vendase. Ajo nuk i rigjykon çështjet, nuk hedh poshtë, nuk ndryshon apo rishikon vendimet e tyre.
- ☞ Gjykata nuk ndërhyt drejtpërdrejt në emrin tuaj tek autoriteti për të cilin jeni ankuar. Megjithatë, në rrethana përjashtimore, Gjykata mund të miratojë marrjen e masave të përkohshme. Praktika ka treguar se ajo e bën këtë vetëm kur integriteti fizik i kërkuesit rrezikohet seriozisht.
- ☞ Gjykata nuk do t'ju ndihmojë të gjeni ose të paguani avokat për përpilimin e kërkesës tuaj.
- ☞ Gjykata nuk mund t'ju japë informacion për dispozitat ligjore në fuqi në shtetin kundër të cilit drejtohen ankesat tuaja.

Pyetje dhe Përgjigje

European Court of Human Rights
Council of Europe
67075 Strasbourg cedex
France

www.echr.coe.int

